

B.E.K.O.J. (java 5 nga 6)

Java 5- O: Ofroj shërbimin ndaj dikujt në nevojë.

(Mateu 7:31-37 Jezusi mori dhe/tokë dhe bëri baltë, ia vuri në sy me nge, i preku veshët, foli... Jezusi i shërbeu me shumë dashuri, ai mund ta kishte bërë mrekullinë në sekondë dhe shpejt e shpejt.)

(Ideja e madhe: Për të bekuar njerëzit në Misionin e Jezusit, ne do t'u shërbejmë individëve dhe komuniteteve në atë nevojë që kuptojmë ndërsa i dëgjojmë këta persona.)

Mirë se vini. Jemi në një nga seritë më të rëndësishme në jetën e kishës sonë, të quajtur "B.E.K.O.J", gjatë së cilës po zbulojmë misionin tonë. Për të zbuluar misionin tënd; gjëja e parë që duhet të kuptosh është se Zoti ynë është një Zot misionar; një Zot me një mision. Ai ka pasur gjithmonë një mision. Cili është misioni i tij? Për të ndihmuar të gjithë njerëzit të gjejnë rrugën e tyre për t'u kthyer tek Ai. Kjo është arsyeja pse Ati dërgoi Birin...dhe pse Biri dërgoi Shpirtin...dhe pse Fryma e Perëndisë po na dërgon ne. Për të përmbushur misionin për të ndihmuar njerëzit të gjejnë rrugën e tyre të kthimit tek Ai! Ky është misioni i Tij. Dhe ky është misioni ynë! Dhe Zoti ka një strategji të veçantë për të përmbushur misionin e Tij: quhet strategji bekimi. Dhe strategjia e bekimit është edhe mënyra se si e përmbush misionin e Jezusit, dhe si e zbulon misionin tënd. E kuptove?

Dhe kjo strategji bekimi vihet në praktikë përmes akronimit B.E.K.O.J. Çdo shkronjë qëndron për një nga 5 praktikat kryesore misionare. Unë po i kërkoj të gjithëve të bëjnë një nga këto çdo ditë dhe të fillojnë një grup të vogël me pyetjen: “Kë bekove ti këtë javë?” Të ndalojmë pak, le të shqyrtojmë se çfarë përfaqëson secila prej shkronjave:

- B? Bjer në gjunjët e lutjes. Pyet Perëndinë çdo ditë: “Si dëshiron që unë ta bekoj botën sot?”
- E? E dëgjo tjetrin. Kjo do të thotë të dëgjosh njerëzit në vendet ku Zoti të dërgon; dëgjo atë që njerëzit po kalojnë dhe kanë nevojë.
- K? K është për të konsumuar kafe/vakte bashkë! Ndani vaktet dhe mikpritjen dhe krijoni lidhje të forta marrëdhëniesh me të tjerët.

Dhe shkronja e sotme është O dhe qëndron për: Ofroj shërbimin ndaj dikujt në nevojë.

Tani të gjithë e dinë se Jezusi u shërbeu njerëzve. Ai është shembulli ynë. Marku 10:45 thotë: *'Sepse edhe Biri i njeriut nuk erdhi që t'i shërbejnë, por për të shërbyer dhe për të dhënë jetën e tij si çmim për shpengimin e shumë vetave'*. Por mënyra më e mirë për të kuptuar shërbimin është të shohësh se si Jezusi e bëri atë. Le të shohim një shembull në librin e Markut.

Shërimi i të Shurdhërit

'Mbasi u nis përsëri nga krahina e Tiros dhe e Sidonit, Jezusi arriti te deti i Galilesë, në mes të krahinës së Dekapolisit. Dhe i paraqitën një të shurdhët që mezi fliste, dhe iu lutën t'i vërë duart mbi të. Si e mori veçmas, larg turmës, ia shtiu gishtërinjtë në vesh dhe mbasi e pështyu ia preku gjuhën. Pastaj i drejtoi sytë nga qielli, psherëtiu dhe i tha: "Effatha", që do të thotë: "Hapu!". Dhe menjëherë iu hapën veshët, iu zgjidh nyja e gjuhës dhe foli rrjedhshëm. Dhe Jezusi i urdhëroi ata që të mos i tregojnë askujt; por sa më tepër ua ndalonte, aq më tepër ata e përhapnin.' Marku 7:31-36

Ndërsa e shohim këtë histori, do të zbulojmë disa fjalë kyçe që përshkruajnë se si Jezusi u shërbeu njerëzve:

Afërsia

Fjala e parë është afërsia. Vini re në shkrimin e shenjtë kujt i shërbeu Jezusi – vargu 32 thotë: *"Dhe i paraqitën një të shurdhët që mezi fliste, dhe iu lutën t'i vërë duart mbi të."* Njerëzit të cilëve u shërbeu Jezusi ishin gjithmonë njerëzit përballë tij, pranë tij, ata në afërsi. Diçka që kam vënë re tashmë gjatë serisë sonë është se ndërsa njerëzit kërkojnë për misionin e tyre - shumë prej nesh duan diçka të madhe, të guximshme dhe madhështore! Është sikur po kërkojmë diçka për të cilën mund të shkruajmë libër. Dhe kur unë sugjeroj, "Po fqinji juaj?" Unë mund ta shoh atë në sytë tuaj, ju po mendoni, "Askush nuk ka marrë kurrë një çmim Nobel për paqen vetëm për dashurinë ndaj fqinjit të tij." Por këtu filloni – filloni me njerëzit pranë jush, përballë jush, në afërsi. Ku punon; ku luan; ku qëndron; në lagjen tënde. Këta janë njerëzit të cilëve duhet t'i ofrosh shërbimin tënd!

Tani, ka disa përjashtime. Nëse ktheheni në fillim të vargut 31, ai thotë: *"Mbasi u nis përsëri nga krahina e Tiros dhe e Sidonit, Jezusi arriti te deti i Galilesë, në mes të krahinës së Dekapolisit."* Zoti ynë misionar e dërgoi Jezusin nga Tiri deri në rajonin e Dekapolit. Pse? Kështu që Jezusi mund të ishte në afërsi të njerëzve që Perëndia donte që ai t'u shërbente. Në të njëjtën mënyrë, disa prej nesh nuk janë në vendin që Perëndia do që të jemi. Disa prej nesh

jetojmë aty ku jetojmë tani, vetëm sepse është shtëpia apo apartamenti më i mirë apo më i madh se ai i fundit... nuk na solli Zoti. Jemi aty ku jeni për shkak të vlerave të pasurive të paluajtshme ose sepse është një sistem shkollor më i mirë, ose kemi marrë një promovim - shumë mirë - por Zoti nuk na dërgoi atje. Dhe për disa prej nesh, për të zbuluar misionin tonë, Perëndia do na zhvendosë në mënyrë që të na vendosë në afërsi me vendin dhe njerëzit që ai dëshiron që ne të bekojmë. Ai do të dërgojë disa prej nesh në një qytet tjetër për të mbjellë një kishë. Disa prej nesh ai do t'i dërgojë në një vend tjetër. Disa prej nesh do të marrin një transferim shpirtëror në nivel lokal në komunitetet me burime të pamjaftueshme. Ju lutem dëgjoni se çfarë do të them tani. Zoti ose ju ka dërguar te njerëzit që duhet t'u shërbeni OSE do t'ju dërgojë te njerëzit të cilëve duhet t'u shërbeni. Pothuajse pa përjashtim, njerëzit të cilëve duhet t'u shërbejmë do të jenë në afërsi. Pikërisht rreth jush! Kush është personi? Merrni një moment dhe lëreni Zotin të sjellë dikë në mendje. E kuptuat?

Në mënyrë perceptuese

Së dyti, vini re si thotë (v. 33) Jezusi "e mori mënjanë". Jezusi e largoi këtë njeri nga vëmendja e turmës. Tani në përgjithësi kur dikush ju merr mënjanë, nuk është gjë e mirë, apo jo?

- Si fëmijë, mbaj mend që prindërit e mi më merrnin mënjanë dhe më thoshin "Siç të kam bërë kokën, ashtu edhe mund të ta këpus". E keni parasysh vetë!
- Ose ndonjëherë gruaja ime më merr mënjanë dhe më jep një vështrim (duke tundur kokën). E keni parasysh vetë!

Por Jezusi e merr mënjanë këtë djalë. Pse? Për t'i shërbyer atij. Pse do ta bënte Ai këtë? Ai kishte shëruar shumë njerëz publikisht më parë, kështu që pse Jezusi e merr mënjanë këtë djalë të veçantë?

Epo, Bibla thotë se ky djalë ishte i shurdhër dhe kishte një pengesë të rëndë në të folur. Pra, me shumë gjasa ai e di se si është të tallen, të të bëjnë spektakël. Vetëm imagjinoni se si ai ndoshta ishte tallur, tallur dhe tallur me pjesën më të madhe të jetës së tij. Sa herë që ky burrë përpiquej të fliste, ngatërrohej duke tërhequr vëmendjen për paaftësinë e tij. Dhe kjo është një nga gjërat e mia të preferuara në këtë histori. Jezusi e kupton këtë dhe refuzon të bëjë një spektakël të gjendjes së tij. Kështu ai "e mori mënjanë" larg turmës. Jezusi po i shërben këtij djali në një mënyrë që tregon se Ai e kupton atë që i nevojitet përtej të dukshmes. Ai i shërben atij me perceptim.

Stephen Covey në librin e tij bestseller **7-Zakonet e njerëzve shumë efektivë**, tregon historinë e të qenit në një metro të Nju Jorkut duke lexuar në heshtje një libër, kur ai u ndërpre nga dy djem të vegjël të zhurmshëm që u nisën me

babanë e tyre në një stacion metroje. Fëmijët nuk ishin thjesht të zhurmshëm, por edhe jashtë kontrollit, duke kërcyer lart e poshtë, duke vrapuar me zë të lartë nëpër vagonin e metrosë. Dhe babai dukej se nuk e vuri re, ose nuk i interesonte vërtet që fëmijët e tij po silleshin keq dhe po shqetësonin të gjithë udhëtarët e tjerë. Më në fund, Stefani nuk mundi të duronte më dhe iu afrua babait dhe i shpjegoi se me të vërtetë kishte nevojë të kontrollonte fëmijët e tij dhe t'u mësonte atyre njëfarë respekti. Babai ra dakord dhe psherëtiu i vrenjtur, duke thënë: "Po, thjesht nuk di çfarë të bëj; dhe vërtet nuk di çfarë t'u them atyre. Sapo erdhëm nga spitali ku vdiq nëna e tyre." Covey e përdori atë histori për të na kujtuar se duhet të "kërkojmë së pari për të kuptuar". Njerëzit që Zoti i ka vënë në afërsi: ku punon; ku luan; ku strehohesh; në lagjen tënde - mos supozo se e di historinë ose dhimbjen e tyre. Ofroji shërbim me perceptim.

Personalisht

OK, ajo ndjesi që kishe në fund të asaj historie - kur mësove se nëna kishte vdekur. E ndjeve? Të dhembti, apo jo? Epo kjo është pikërisht ajo që ndodh me Jezusin në historinë tonë. Jezusi shkon përtej vetëm perceptimit të dhimbjes së këtij njeriu; ai në fakt hyn në dhimbjen e njeriut dhe e ndjen atë personalisht. Shihni ku thotë Jezusi "ngriti sytë nga qielli dhe me një psherëtimë të thellë i tha: "Effatha!" Në gjuhën origjinale kjo nuk ishte një psherëtimë siç mendojmë për një psherëtimë. Ishte një lloj i thellë personal rënkimi. E dini, si kur merrni një lajm vërtet të keq për dikë afër jush dhe pa e menduar fare, thjesht shpreheni "Ohhhhhhh". Jezusi po ndjen për atë që ka kaluar ky djalë. Shiko, Jezusi nuk ishte thjesht një makinë shërbyese që po bënte vepra dashamirësie kudo që shkonte. Ai ishte thellësisht i prekur nga vuajtjet e njerëzve të cilëve u shërbente.

"Kujtdo që jemi thirrur t'i shërbejmë, duhet të ndjejmë dhimbjen e tyre."

Ndërsa shërbeu, Ai me guxim hyri në dhimbjen e njerëzve që po bekonte. Shërbimi ndaj të tjerëve do bërë personal. Duhet.

Në mënyrë të fuqishme

E kuptove? Shërbeu në afërsi, shërbeu me perceptim, shërbeu personalisht dhe së fundi, shërbeu fuqishëm. Mos e kalo vetëm ngjarjen e madhe të kësaj historie. Aty thuhet: "Jezusi ngriti sytë nga qielli dhe me një psherëtimë të thellë i tha: "Effatha!" (që do të thotë "Hapu!"). Me këtë, burrit iu hapën veshët, iu lirua gjuha dhe filloi të fliste qartë." Diçka dua të mësojmë nga kjo histori. Në shërbimin, Jezusi përdori dhe iu qas fuqisë së Perëndisë...kështu duhet të bëjmë

dhe ne gjithashtu! Ne jemi të gjithë të ndezur dhe të motivuar për të zbuluar misionin tonë dhe për t'u shërbyer njerëzve përreth nesh. Duaje atë! Dhe kur mendojmë të shërbejmë, mendojmë të bëjmë gjëra të mira: çdo gjë. Dhe kjo është e madhe dhe kjo është ajo që ne duhet të bëjmë. Por ne nuk duhet të harrojmë kurrë se në shërbimin tonë ne kemi në dispozicion fuqinë e Perëndisë. Dhe ju mund të mendoni: "Por ky ishte Jezusi, sigurisht që ai bën mrekulli; por jo unë." Vërtet? A e dini se tek Gjoni 14:12 Jezusi u tha dishepujve të tij: "Në të vërtetë, në të vërtetë po ju them: kush beson në mua do të bëjë edhe ai veprat që bëj unë; madje do të bëjë edhe më të mëdha se këto, ..." ju kujtoj se kur u shërbeni njerëzve:

- Nëse janë të sëmurë, lutuni dhe kërkojini Zotit t'i shërojë.
- Nëse ata kanë një varësi, kërkojini Zotit t'i çlirojë.
- Nëse ata kanë një marrëdhënie të pashpresë, kërkojini Zotit t'i pajtojë.

E kuptoni idenë. Mos kini frikë të kërkonit një mrekulli!

Shumë njerëz thonë: "Zoti duhet të jetë i vërtetë..." vetëm pasi shohin mrekulli si përgjigje lutjesh. Ata shohin fuqinë e Perëndisë në veprim! Mos harro fuqinë në shërbimin tënd. Fuqia e Zotit!

Konkluzioni:

Ok, para se të mbarojmë kam disa sfida specifike për ju. Pra, filloni të përgatiteni për veprim. Por së pari le të shqyrtojmë se si shërbeu Jezusi dhe si duhet të shërbejmë ne:

- Afërsia: Kjo mund të duket e qartë, por duhet thënë. Dhe nuk po flas për familjen tuaj. Shërbimi ynë duhet të shkojë përtej mureve të kësaj ndërtese dhe gjithashtu mureve të shtëpisë sonë: ku punon; ku luan; ku qëndron; në lagjen tënde. Disa prej nesh mendojnë se kjo është diçka që duhet ta shtojmë në jetën tonë – jo! Kjo është diçka që bëni gjatë gjithë jetës! Mbani mend: Zoti ose ju ka dërguar te njerëzit që duhet t'u shërbeni OSE do t'ju dërgojë te njerëzit që duhet t'u shërbeni.
- Në mënyrë perceptuese: Së pari, kërkonit të kuptoni. Mos supozoni se e dini të gjithë historinë. Mos supozoni se e dini dhimbjen e tyre.
- Personalisht: kujt do që jemi thirrur t'i shërbejmë, duhet të ndiejmë dhimbjen e tyre.

- Fuqishëm: Kërkojini Perëndisë të bëjë atë që vetëm Ai mund të bëjë!

(shënim për pastorin:
opsionale:

Kjo seri do jetë me life-story të ndryshme (të lidhura drejtpërdrejt me mesazhin), dua të ftoj persona që do të ndajnë momente nga jeta e tyre në lidhje me:

si i kam ofruar shërbimin tim x personi, ndikimi)

Ok, para se të dalim dhe bekojmë botën, unë dua t'ju jap një sfidë. Sepse gjëja e fundit që dua është që ne të mësojmë të gjitha këto mësimë nga Jezusi dhe të mos bëjmë asgjë.

Sfida 1:

Zhvendosu - Zoti ose të ka dërguar te njerëzit që duhet t'u shërbesh OSE do të të dërgojë te njerëzit që duhet t'u shërbesh. Ka një përqindje të vogël prej jush që ndërsa më keni dëgjuar duke folur për Zotin duke ju shtyrë të përfshiheni në një kishë ose duke ju transferuar në një komunitet me burime të pamjaftueshme për t'u shërbyer atyre njerëzve, kishte diçka brenda jush (Fryma e Shenjtë) duke thënë: Ky jam unë... Mendoj se duhet ta bëj këtë." Këtu është sfida: Unë dua që ti të fillosh ato diskutime me ata të afërt që ke besim dhe të dallosh nëse kjo është ajo që supozohet të bësh: të zhvendosesh në vendin dhe te njerëzit që Zoti ka dashur gjithmonë që t'i shërbesh. Sfidë e madhe. Jo ajo që prisje. Ti duhet ta bësh këtë.

Sfida 2:

Veprim 24 orësh –Ndërsa unë po flisja, besoj se ishte të paktën një person që të erdhi në mendje në mënyrë specifike. Me "A"-në e parë të Afërsisë ty të erdhi në mendje se kush është ai që supozohet t'i shërbesh. Mund të jetë një fqinj që po kalon një kohë të vështirë financiare. Mund të jetë një nënë beqare që njeh, mund të jetë një person i pastrehë pranë të cilit kalon çdo ditë. Këtu është sfida: Bëj diçka për t'i shërbyer atij personi sot! Në 24 orët e ardhshme. Jo nesër. Jo në një moment më të përshtatshëm. Tani! Ti mund të shkosh menjëherë dhe të blesh drekën e atij personi të pastrehë. Ti mund të blesh sende ushqimore për atë nënë beqare. Ti mund të ndihmosh atë familje që po kalon periudha të vështira

financiare. E kupton. Por nëse një person të erdhi në mendje, unë dua që ti të marrësh masa në 24 orët e ardhshme.

E kuptove? Mirë! Mbaj mend, ne jemi njerëzit që Perëndia ka zgjedhur për të bekuar botën. Ne u drejtohemi atyre përreth nesh. Ne e rivendosim ëndrrën e Zotit aty ku është thyer. Ne e riprodhojmë misionin tek të tjerët. Pse? Pra, ne mund ta shohim misionin e Jezusit të përmbushur – që njerëzit të gjejnë rrugën e tyre për t'u kthyer te Zoti.

Le të lutemi!